VENDIM
Nr. 16, datë 11.1.2024

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2024–2026

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, sipas tekstit dhe shtojcës që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator ngarkohet të bashkërendojë zbatimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026 me ministrat dhe/ose drejtuesit e institucioneve përgjegjëse për kryesimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian (GNPIE), si dhe negociatorin përgjegjës të secilit kriter dhe/ose kapitull të *acquis* të Bashkimit Evropian.
3. Negociatori përgjegjës për kriterin dhe/ose kapitullin e *acquis* të Bashkimit Evropian, i caktuar sipas parashikimeve të vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", të ndryshuar, raporton në mënyrë periodike pranë ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator për ecurinë e zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026.
4. Vendimi nr. 122, datë 1.3.2023, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2023–2025", shfuqizohet.
5. Ngarkohen të gjitha institucionet, në përbërje të grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian, për të cilat në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026 janë përcaktuar detyra të veçanta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN 2024–2026
Janar 2024

Përmbledhje

Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian mbetet objektivi kryesor strategjik i Republikës së Shqipërisë. Qeveria shqiptare në programin e saj qeverisës ka përcaktuar se "*Europa e Bashkuar është busulla jonë dhe familja natyrale të cilës i përkasim, por ku ende mungojmë*".[1]

Integrimi Evropian është synimi politik dhe strategjik më i rëndësishëm i Shqipërisë dhe i sistemeve të saj ligjore, ekonomike dhe institucionale. Procesi i integrimit në BE përfaqëson mbështetjen për demokratizimin e Shqipërisë, konsolidimin e institucioneve dhe të sundimit të ligjit dhe proceseve të vazhdueshme të reformave themelore në drejtim të Bashkimit Evropian dhe anëtarësimit të plotë.

Vizioni dhe objektivat strategjikë kombëtarë për Integrimin Evropian përcaktohen në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Evropian (SKZHIE) 2024–2026. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian si dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë përcakton se vizioni i Republikës së Shqipërisë për periudhën 2024–2026 është

[1] https://kryeministria.al/ëp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf

"*Shqipëria 2030: Një ekonomi dinamike, pjesë e Bashkimit Evropian dhe rajonit, që ofron kushte të barabarta për rritjen e mirëqenies së të gjithë qytetarëve të saj mbështetur në një demokraci funksionale që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut*"[2]. Ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përparësive që synojnë transformimin e gjithanshëm të Shqipërisë drejt një vendi me standarde që mundësojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Zhvillimi i Konferencës së Parë Ndërqeveritare, më 19 korrik 2022, shënoi fillimin zyrtar të negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Hapja e negociatave mbi bazë merite ishte një arritje historike për Shqipërinë, por në të njëjtën kohë ajo shënoi edhe fillimin e një procesi transformues të gjithanshëm për Shqipërinë.

Procesi i negociatave dhe, më pas, anëtarësimi në Bashkimin Evropian, do të mbështesë më tej demokratizimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, do të nxisë konsolidimin e institucioneve publike dhe vazhdimin e proceseve reformuese, duke përshpejtuar zhvillimin ekonomik dhe përqasjen me nivelet më të mira evropiane të mirëqenies, konvergjencës dhe gjithëpërfshirjes sociale.

Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton angazhimin e Republikës së Shqipërisë për të përafruar legjislacionin shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian[3]. Pika 1 e tij përcakton "Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.

Njëkohësisht, përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, dhe zbatimi i plotë dhe efektiv i tij, janë një nga kriteret e Kopenhagës për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Procesi i negociatave të anëtarësimit është në vetvete procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe i përmbushjes së piketave hapëse, të ndërmjetme dhe mbyllëse të negociatave të anëtarësimit dhe kritereve për anëtarësim.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (në vijim "PKIE") ka si synim të adresojë përmes masave të politikës (dokumenteve strategjike) dhe ligjore, institucionale dhe zbatuese linjëzimin e kuadrit rregullator vendas me *acquis* të BE-së, si dhe zbatimin efektiv të tij.

PKIE-ja është e lidhur me ciklin e programimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe në të njëjtën linjë me PBA mbulon një periudhë 3-vjeçare buxhetimi dhe përditësohet çdo vit.

Gjithashtu çdo projektvendim i Këshillit të Ministrave dhe projektligj i planifikuar në PKIE-në, duhet të jetë pjesë e listës së akteve që janë parashikuar për miratim në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve.

Cikli i hartimi dhe monitorimit të PKIE-së përbëhet nga këto procese:

1. Puna përgatitore;
2. Analiza e mangësive;
3. Planifikimi;
4. Hartimi dhe kontrolli i cilësisë;
5. Konsultimi dhe miratimi;
6. Monitorimi, raportimi, dhe vlerësimi.

Veçanërisht të rëndësishme në këtë cikël planifikimi dhe monitorimi janë fazat e analizës së mangësive dhe planifikimit.

Në analizën e mangësive ligjore dhe përcaktimin e masave prioritare në PKIE, institucionet përgjegjëse kanë pasur në vëmendje të veçantë:

- angazhimet e marra në kuadër të procesit *screening* tashmë të përmbyllur më datë 24.11.2023;
- rekomandimet e Komisionit në projektraportin *screening* (aktualisht i përgatitur për grupkapitullin 1 "Themelorët" dhe në pritje për grupkapitujt e tjerë);

---

[2] https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/22/88

[3] https://qbz.gov.al/eli/ligj/2006/07/27/9590/92c1cfc1-2743-4c3f-9750-e36fdd90a9cc

- angazhimet e marra në udhërrëfyesit përkatës për grupkapitullin 1 "Themeloret" ("Shteti i së Drejtës"; "Reforma në Administratën Publike"; Funksionimi i Institucioneve Demokratike);

- rekomandimet e Komisionit në Raportin e vitit 2023 për Shqipërinë;

- rekomandimet e dhëna në kuadër të takimeve dhe mekanizmave të përbashkëta të ngritura në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;

- përputhshmërinë me objektivat strategjikë të Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030[4] dhe Programin e Qeverisë shqiptare[5] si dhe dokumentet e tjera strategjike të miratuara.

Në bazë të urdhrit të Kryeministrit nr. 94, datë 20.5.2019, grupet ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian, janë përgjegjëse për bashkërendimin e hartimit dhe përditësimit të kapitullit përkatës të PKIE-së. Për këtë arsye, hartimi i projektakteve dhe monitorimi i procesit të finalizimit të tyre me procedura miratuese duhet të bëhet në konsultim të vazhdueshëm me ministrinë/ institucionin koordinues lider dhe anëtarët e tjerë të grupit ndërinstitucional të punës.

Raportet e monitorimit të realizimit të PKIE-së janë pjesë e raportimeve 4-mujore në bazë kapitulli të negociatorëve drejt ministrit të Shtetit dhe kryenegociator dhe të këtij të fundit drejt Këshillit të Ministrave. Gjithashtu ato shërbejnë për raportet periodike për Kuvendin e Shqipërisë, bazuar në ligjin nr. 15/2015 "Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian".

Drejtimet kryesore të punës

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2024–2026 përfshin masa ligjore dhe të politikave, masa institucionale dhe administrative, dhe masa zbatuese që shtrihen deri në vitin 2026, duke synuar përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian, si dhe forcimin e kapaciteteve dhe zbatimin e tij.

Në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026 janë planifikuar në total 236 masa ligjore të detajuara sipas tabelës bashkëlidhur.

Për vitin 2024, janë planifikuar 102 masave ligjore të kategorizuara si më poshtë:

- 29 projektligje;
- 35 projektvendime të Këshillit të Ministrave;
- 38 projekturdhra apo akte të tjera nënligjore.

Ndër aktet më të rëndësishme që synohet përafrimi me *acquis* të Bashkimit Evropian gjatë vitit 2024 mund të përmendim:

- Në grupkapitullin 1 "Themelorët: projektligjin "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", projektligjin "Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve", projektligji "Për mbrojtjen e të dhënave personale", dhe projektligjin "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat".

- Në grupkapitullin 2 "Tregu i brendshëm", mund të përmendim, projektligjin "Për markat tregtare, projektligjin "Për patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë", si dhe projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 52, datë 22.5.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

- Në grupkapitullin 3 "Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse", është parashikuar të miratohen projektligji "Për sigurinë kibernetike", projektligji "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara" dhe projektligji "Për shkencën".

- Në grupkapitullin 4 "Agjenda e gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm", është parashikuar miratimi i ndryshimeve në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë", projektligji "Për eficiencën e energjisë" dhe projektligji "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji".

- Në grupkapitullin 5 "Burimet, bujqësia dhe kohezioni", është parashikuar miratimi i projektligjit "Për prodhimin biologjik dhe etiketimin e produkteve biologjike", projektligjit "Për shëndetin e bimëve" dhe projektligjit "Për shëndetin e kafshëve".

Për vitin 2024, janë planifikuar edhe 20 masa institucionale dhe zbatuese.

---

[4] https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/22/88

[5] https://kryeministria.al/ëp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf

Ndër masat institucionale dhe zbatuese më të rëndësishme gjatë vitit 2024 mund të përmendim:

- Në grupkapitullin 1 "Themelorët" mund të përmendim zbatimin e fazës pilot të Planit të miratuar të garancisë rinore, trajnime për oficerët e parregullsive në programimin dhe implementimin e asistencës së Bashkimit Evropian.

- Në grupkapitullin 2 "Tregu i brendshëm", është parashikuar ofrimi i informacionit të dedikuar për punëtorët nga Bashkimi Evropian që punojnë ose qëndrojnë për motive pune në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe analiza e legjislacionit shqiptar në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve, si dhe analiza e ligjit nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik".

- Në grupkapitullin 3 "Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse", janë parashikuar të zbatohen masa në lidhje me promovimin e investimeve në rrjetin 5G, zgjerimin e rrjetit të internetit, trajnimi i personelit të AKCESK për sigurinë kibernetike dhe investime të mëtejshme për sigurinë kibernetike.

- Në grupkapitullin 4 "Agjenda e gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm", është parashikuar zbatimi i masave për forcimin e kapaciteteve dhe bashkërendimit në sektorin e transportit hekurudhor.

- Në grupkapitullin 5 "Burimet, bujqësia dhe kohezioni", është parashikuar ngritja e Komitetit Kombëtar për Bashkëpunimin Territorial Evropian dhe metodologjisë së forcimit të kapaciteteve për të mbuluar objektivat e politikave të kohezionit.

- Në grupkapitullin 6 "Marrëdhëniet me jashtë" është parashikuar hartimi i kuadrit rregullator për bashkëpunimin ndërkombëtar për zhvillim dhe ndihmë humanitare.

Për vitin 2025 është parashikuar miratimi i 91 masave ligjore:

- 23 projektligjeve;
- 37 projektvendimeve të Këshillit të Ministrave;
- 31 projekturdhra apo akte të tjera nënligjore.

Ndër aktet më të rëndësishme që synohet përafrimi me *acquis* të Bashkimit Evropian gjatë vitit 2025 mund të përmendim:

- Në grupkapitullin 1 "Themelorët: projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" dhe projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri".

- Në grupkapitullin 2 "Tregu i brendshëm", mund të përmendim, projektligjin "Për disenjot industriale", projektligjin "Për produktet e ndërtimit", dhe projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 66/2016 "Për shërbimet".

- Në grupkapitullin 3 "Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse", është parashikuar të miratohen projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 75/2019 "Për rininë" dhe projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 45/2016 "Për vullnetarizmin".

- Në grupkapitullin 4 "Agjenda e gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm", parashikohet miratimi i projektligjit "Për krijimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë së naftës bruto dhe produkteve të naftës", projektligjit "Për lejet e mjedisit" dhe projektligjit "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

- Në grupkapitullin 5 "Burimet, bujqësia dhe kohezioni", është parashikuar miratimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8337, datë 30.4.1998, "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave".

Për vitin 2025, janë planifikuar edhe 21 masa institucionale dhe zbatuese.

Ndër masat institucionale dhe zbatuese më të rëndësishme gjatë vitit 2024 mund të përmendim:

- Në grupkapitullin 2 "Tregu i brendshëm", është parashikuar analiza e legjislacionit shqiptar në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve, si dhe analiza e ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore: dhe ligjit nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik".

- Në grupkapitullin 3 "Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse", janë parashikuar të zbatohen masa në lidhje me promovimin e investimeve dhe sigurisë kibernetike në rrjetin 5G, hartimi i projektligjit "Për qarkullimin e lirë të të dhënave jopersonale", hartimi i një plani veprimi

për sigurinë e profesionistëve të medias në Shqipëri, trajnimi i stafit të Autoritetit të Medias Audiovizive dhe forcimi i kapaciteteve për negociatat në Kapitullin 20.

- Në grupkapitullin 4 "Agjenda e gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm", është parashikuar zbatimi i masave për forcimin e kapaciteteve dhe bashkërendimit në sektorin e transportit hekurudhor.

- Në grupkapitullin 5 "Burimet, bujqësia dhe kohezioni", është parashikuar ngritja e Bordit të Monitorimit për Zhvillimin Rajonal, strukturave koordinuese me Komisionin Evropian për asistencën e Bashkimit Evropian dhe metodologjia e trajtimit të parregullsive në përdorimin e fondeve.

Për vitin 2026 është parashikuar miratimi i 43 masave ligjore:

- 11 projektligjeve;
- 13 projektvendimeve të Këshillit të Ministrave;
- 19 projekturdhra apo akte të tjera nënligjore.

Ndër aktet më të rëndësishme që synohet përafrimi me *acquis* të Bashkimit Evropian gjatë vitit 2026 mund të përmendim:

- Në grupkapitullin 1 "Themelorët: projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë", projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10193, datë 3.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit", si dhe projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

- Në grupkapitullin 3 "Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse", është parashikuar të miratohet projektligji "Për krijimin e një fondi garancie për punëmarrësit në rast falimentimi të punëdhënësit të tyre".

- Në grupkapitullin 4 "Agjenda e gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm", është parashikuar miratimi i projektligjit "Për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e emetimeve të dyoksidit të karbonit nga transporti detar" dhe i projektligjit "Për uljen e përmbajtjes së squfurit në lëndë djegëse të caktuara të lëngshme.

- Në grupkapitullin 6 "Marrëdhëniet me jashtë", është parashikuar miratimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 46/2018 "Për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë".

Për vitin 2026, janë planifikuar edhe 7 masa institucionale dhe zbatuese.

Ndër masat institucionale dhe zbatuese më të rëndësishme gjatë vitit 2024 mund të përmendim:

- Në grupkapitullin 2 "Tregu i brendshëm", është parashikuar rishikimi i ligjit nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" dhe përmirësimi i organizimit dhe funksionimit të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

- Në grupkapitullin 4 "Agjenda e gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm", është parashikuar zbatimi i masave për forcimin e kapaciteteve dhe ndërveprueshmërisë në sektorin e transportit hekurudhor.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian do të rishikohet në fund të vitit 2024 për të pasqyruar edhe gjetjet dhe rekomandimet e shërbimeve të Komisionit Evropian në raportet *screening* për çdo grupkapitull.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026

STRUKTURA E KAPITUJIT				EU Acquis që përafrohen		PLANIFIKIMI									BUXHETI Buxheti				Burimet shtesë			
Kapitulli	Institucioni LidER	Nën-Kapitulli	Çështja	Titulli i EU Acquis / Rekomandimit	ELI	Lloji i masës së planifikuar	Emërtimi i aktit	Fushat/aktivitetet ku synohet përafrimi	Lloji i aktit të miratuar ose (vetëm për masat ligjore)	Vlerësimi paraprak i niveltë të prekshëm të përafrimit (vetëm për masat ligjore dhe bujqësi)	Institucionet propozuese	Viti (gjatë gjashtëmujorit a mas ai)	Kadromaj ori i projektuar e për miratim	Burimi i financimit	2024	2025	2026	Burimi i financimit	2024	2025	2026
Themelore/Kërcënim Politik	DAP	Reforma e Administratës Publike (BaP)	Partmi 3 i Administratës Publike	Pikatat hapësore/kohëmbrëtësi RAP	-	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar"	Fusha "Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore"	Ligj	N/A	Kryeministri	2024	Q3	Buxheti shtetit	1,858						
Themelore/Kërcënim Politik	DAP	Reforma e Administratës Publike (BaP)	Partmi 4 i Administratës Publike	Pikatat hapësore/kohëmbrëtësi RAP	-	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"	Fusha "Organizimi, llogaridhënia dhe transparenca"	Ligj	N/A	Kryeministri	2024	Q3	Buxheti shtetit	1,858						
23	MD	Politikat kundër korrupsionit	Sinjalizuesit	Direktiva 2003/108/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 13 tetor 2019 për mbrojtjen e personave që raportojnë shkeljet e ligjit të Unionit	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/sq/TXT/?uri=CELEX:32019L1937	Politike dhe Ligjore	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 60/2016 "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve"	Qasja sektoriale kundër aktit korruptiv/mashtrim, mbrojtja e sinjalizuesve, sensibilizimi, mbledja e ligjit të Unionit, raportimi i rasteve të mundshme të korrupsionit, kanale të brendshme të raportimit, rajisi sinjalizimi.	Ligj	E pësht (e pëlqyeshme)	MD	2025	Q3	Buxheti shtetit		21.223					
23	MD	Politikat kundër korrupsionit	Kuadri Strategjik dhe Legislativ	Rekomandim i Raportit të KE për Shqipërinë 2023 Një strategji e re për vitin 2023-2030 është në përgatitje, në të cilën duhet ti kushtohet më shumë vëmendje sektorëve më të cenueshëm ndaj korrupsionit, të cilët kërkojnë vlerësime të synuara mbrojtëse dhe veprime të shpejtuara, mekanizma të shtuesh monitorimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe gjithashtu të synojë të sikurajë pronësinë dhe të bëjë bashkëpunë institucionet.		Politike dhe Ligjore	Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030"	Qasje ndërsektoriale parandalimndëshkim-edukim/qytetarësi, qasje sektoriale,sektorët kyç me të njëjashëm të korrupsionit.	VKM	N/A	MD	2024	Q1	Buxheti shtetit	3,909.00						
23	MD	Politikat kundër korrupsionit/Të drejtat e njeriut	Kuadri Ligjor/korrupsion /Luftëra ndërmjet korrupsionit dhe fashazë të lartë/ Masat për të luftuar racizmin dhe kseno/fobitë, krimin e organizëm dhe krimin e urrejtjes	1-Direktiva (BE) 2017/1371, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 5 korrikut 2017, mbi luftim kundër mashtrimit ndaj interesave financiarë të Bashkimit me anë të ligjit penal; (Kap. 23) 2-Direktiva (BE) 2015/849, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 20 majit 2015, mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, duke ndryshuar Rregulloren (BE) nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe i Këshillit dhe shfuqizimi i direktivës 2005/60/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe direktivës së Këshillit dhe Komisionit 2006/70/KE (tekst me rëndësi për EEA); (Kap. 23) 3-Direktiva 2014/42/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 3 prillit 2014, mbi ngrijjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi në Bashkimin Evropian; (Kap. 23) 4-Direktiva (BE) 2017/541, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 mars 2017, mbi luftim kundër terrorizmit dhe zëvendësimin e vendimit Kornizë të Këshillit 2002/475/JA3HA dhe ndryshimin e vendimit të Këshillit 2005/671/JHA (Kap. 24) 5-Direktiva (BE) 2019/1937, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 maj 2014, mbi mbrojtjen e euros dhe monedhave të jashta kundër falsifikimit nga ligji penal dhe zëvendësimin e vendimit Korniz të Këshillit 2000/383/JA3HA (Kap. 24); 6-Direktiva 2011/36/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 5 prillit 2011, mbiparandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të saj,dhe zëvendësimin e vendimit të Këshillit 2002/629/JA3HA (Kap. 24); 7-Direktiva 2011/93/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 13 dhjetorit 2011, mbiluftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve, dhe zëvendësimin e vendimit Korniz të Këshillit 2004/68/JA3HA (Kap. 24); 8-Direktiva (BE) 2017/2103, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 dhjetor 2017, mbi ndryshimin e vendimit Korniz të Këshillit 2005/387/JA3HA (Kap. 24); 9-Direktiva 2019/713/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi luftim kundër mashtrimit dhe falsifikimit të mjeteve të pagesave jo në fotë, e cila zëvendësohet Vendimin Kuadër të Këshillit 2001/413; 10-Direktiva 2013/40/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi sulmet kundër sistemeve informatike, e cila zëvendësohen Vendimin Kuadër të Këshillit 2005/222; 11-Vendimi Kuadër 2008/913 mbi luftimin e formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë me anë të ligjit penal;	https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2017/1371/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2015/849/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2014/42/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2017/541/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2019/1937/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2011/36/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2011/93/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dec_framw/2004/757/2002-06-18 https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2019/713/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2013/40/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dec_framw/2008/913/oj	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për miratimin e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë"	Vepra kriminale në lidhje me luftim kundër mashtrimit, terrorizmit, trafikut të drogës, shfrytëzimit të fëmijëve, falsifikimit të monedhave, falsifikimit të mjeteve të pagesave, racizmit dhe kseno/fobisë. Rishikimi i terminologjisë penale sipas standardeve dhe sankseteve proporcionale. Përafrimi i legjislacionit në lëmin me përgjegjësinë penale të personave juridik. Disposita për sanksione parandaluese në pajtojnë me acquis të BE-së dhe Konventën e OKB-së kundër korrupsionit. Shqyrtimi i veprës penale të shpëlarjes dhe financimit ndërkombëtar. Rishikimi i veprave penale në lidhje me gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes Rishikimi i çështjeve të pëshkuarisë. Rishikimi i veprës penale të organizimit dhe qëndrimarjes në kufirin dhe demonstrata të paligjshme" sipas vendimit nr.24/2021 të Gjykatës Kushtetuese.	Ligj	E pësht (e pëlqyeshme)	MD	2024	Q3	Buxheti shtetit	29.364						
23	MD	Të drejtat e njeriut	Mbrojtja e të dhënave personale	1. Rregullorja (BE) 2016/679, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 27 prillit 2016, mbi mbrojtjen e personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla, dhe shfuqizimin e direktivës 95/46/CE (Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave) (F.2.L119.1 e maji 2016, f. 1); 2. Direktiva (BE) 2016/680, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 27 prill 2016, "Për mbrojtjen e personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, dhe për lëvizjen e lirë e të dhënave të tilla dhe shfuqizimin i vendimit Kornizë të Këshillit 2008/977/JHA (F.2 L119, i 4 maji 2016, f. 89).	https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2016/679/oj https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/ALL/?uri=celex%3A32016L0680	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për mbrojtjen e të dhënave personale"	Të dhëna personale, përpunim të dhënash, liria e lëvizjes së të dhënave.	Ligj	E pësht (e pëlqyeshme)	MD	2024	Q3	Buxheti shtetit	4.195						
23	MD	Të drejtat e njeriut	Të drejtat procedurale	Direktiva 2010/64/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procesin penal;	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/TXT/?uri=celex%3A32010L0064	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 82/2012 "Për pëkthimin zyrtar dhe profesionin e pëkthyesit zyrtar"	Pëkthimi zyrtar, pëkthyesi, proces penal, e drejta e interpretimit.	Ligj	E pëlqyeshme	MD	2024	Q3	Buxheti shtetit	4.363						
23	MD	Të drejtat e njeriut	Të drejtat procedurale	Direktiva 2010/19/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 për ndërmjetësimin juridik për të dyshuarit dhe personat e akuzuar në procedurat penale dhe për personat e kërkuar në procedurën e arrestit evropian.	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/TXT/?uri=CELEX%3A32010L1919-20161104	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"	Ndihma juridike, procedurat penale, procedurat e arrestit evropian, personat e akuzuar, personat e dyshuar.	Ligj	E pëlqyeshme	MD	2026	Q3	Buxheti shtetit			6.194				
23	MD	Të drejtat e njeriut	Të drejtat procedurale	1-Direktiva 2010/64/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procesin penal; 2-Direktiva 2012/13/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 maj 2012 mbi të drejtën e informimit në procesin penal; 3-Direktiva 2013/48/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi të drejtën e akesit ndaj një avokati në procesin penal dhe procedurat e urdhrit evropian të arrestit dhe për të drejtat e një palë të tretë që ka informuar punonin e lirë dhe komunikimin me të treti dhe me autoritetet konsulorë në rastet që i është hequr lëria; 4-Direktiva 2016/343/BE për forcimin e disa aspekteve të pranisisë së palës gjykimi dhe të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim; 5-Direktiva 2016/800/BE mbi masat mbrojtëse procedurale për fëmijët që janë të dyshuar dhe të akuzuar në procesin penal; 6- Direktiva 2016/1919/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 për ndihmën juridike për të dyshuarit dhe personat e akuzuar në procedurat penale dhe për personat e kërkuar në procedurën e arrestit evropian.	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/TXT/?uri=celex%3A32010L0064 https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/TXT/?uri=celex%3A32013L0013 https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/TXT/?uri=celex%3A32013L0048 https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/TXT/?uri=celex%3A32016L0343 https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/TXT/?uri=CELEX%3A32016L1919-20161104 https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/TXT/?uri=CELEX%3A32016L0800	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarëveshjeve administrative", të ndryshuar	E drejta e interpretimit, pëkthimi, informimi, proces penal, e drejta e akesit, komunikimi me të treti, pranisimi i palës/palës, masat mbrojtëse procedurale.	Ligj	E pëlqyeshme	MD	2026	Q3	Buxheti shtetit			5.993				
23	MD	Të drejtat e njeriut	Të drejtat procedurale	1-Direktiva 2010/64/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procesin penal; 2-Direktiva 2012/13/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 maj 2012 mbi të drejtën e informimit në procesin penal; 3-Direktiva 2013/48/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi të drejtën e akesit ndaj një avokati në procesin penal dhe procedurat e urdhrit evropian të arrestit dhe për të drejtat e një palë të tretë që ka informuar punonin e lirë dhe komunikimin me të treti dhe me autoritetet konsulorë në rastet që i është hequr lëria; 4-Direktiva 2016/343/BE për forcimin e disa aspekteve të pranisisë së palës gjykimi dhe të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim; 5-Direktiva 2016/800/BE mbi masat mbrojtëse procedurale për fëmijët që janë të dyshuar dhe të akuzuar në procesin penal; 6- Direktiva 2016/1919/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 për ndihmën juridike për të dyshuarit dhe personat e akuzuar në procedurat penale dhe për personat e kërkuar në procedurën e arrestit evropian.	https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2010/64/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2012/13/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2013/48/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2016/343/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2016/800/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2016/1919/oj	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitunë"	Rishikimi dhe plotësimi i hendasjeve në pëkthimin e dispozitave lidhur me të drejtat procedurale për të mituri e dyshuar dhe të akuzuar në procedurë penale.	Ligj	E pëlqyeshme	MD	2026	Q3	Buxheti shtetit			6.197				
23	MD	Të drejtat e njeriut	Të drejtat procedurale	1-Direktiva 2010/64/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 mbi të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procesin penal; 2-Direktiva 2012/13/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 maj 2012 mbi të drejtën e informimit në procesin penal; 3-Direktiva 2013/48/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi të drejtën e akesit ndaj një avokati në procesin penal dhe procedurat e urdhrit evropian të arrestit dhe për të drejtat e një palë të tretë që ka informuar punonin e lirë dhe komunikimin me të treti dhe me autoritetet konsulorë në rastet që i është hequr lëria; 4-Direktiva 2016/343/BE për forcimin e disa aspekteve të pranisisë së palës gjykimi dhe të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim; 5-Direktiva 2016/800/BE mbi masat mbrojtëse procedurale për fëmijët që janë të dyshuar dhe të akuzuar në procesin penal; 6- Direktiva 2016/1919/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2016 për ndihmën juridike për të dyshuarit dhe personat e akuzuar në procedurat penale dhe për personat e kërkuar në procedurën e arrestit evropian.	https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2012/13/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2013/48/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2016/343/oj https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2016/1919/oj	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për njoftimshmërinë juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale",	Rishikimi dhe plotësimi i hendasjeve në pëkthimin e dispozitave që lidhen me të drejtat procedurale në procedurë e urdhrit të arrestit evropian.	Ligj	E pëlqyeshme	MD	2026	Q3	Buxheti shtetit			6.206				
23	MD	Të drejtat e njeriut	Barazia gjinore	Komunikimi i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajonave "Një Union i Barazisë: Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025" COM/2020/152 final	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0152	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9970/2008 "Për Barazinë Gjinore në Shqipëri"	Ndryshime ligjore për përmirësimin e legjislacionit të barazisë gjinore.	Ligj	E moderuar (e pëlqyeshme)	MSHMS	2025	Q3	Buxheti shtetit		3,769					
23	MD	Të drejtat e njeriut	Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara	Komunikimi i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajonave "Union i Barazisë: Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030" COM/2021/101 final	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/TXT/?uri=CELEX:52021DC0101	Politike dhe Ligjore	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar"	Plan kombëtar, personat me aftësi të kufizuara, mbrojtja e të drejtave.	VKM	N/A	MSHMS	2026	Q2	Buxheti shtetit			2,931				
23	MD	Të drejtat e njeriut	Raniti dhe Egjipteniti	Direktiva e Këshillit 2003/4/KE e 29 qershorit 2003 për ziatësinë e paintë të trajnimit të banabanitë mes personave, pavarësisht nga origjina racore ose etnike OJ L 180, 19.7.2000, f. 22-26 EUR-Lex	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/TXT/?uri=CELEX:32003D0003	Politike dhe Ligjore	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit Kombëtar për Banaznë, Fëmijërinë dhe Familjarizmin e paktikuar Rom dhe Egjiptanë"	Trajnim i banabanitë, plani kombëtar, fëmijëria, romët, egjiptanët.	VKM	N/A	MSHMS	2026	Q3	Buxheti shtetit			2,931				
24	MB	Luftra kundër krimit të organizuar		Direktiva e BE 2014/42/EU e datës 3 prill 2014 mbi ngrijjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të veprave penale në Bashkimin Evropian	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/TXT/?uri=CELEX%3A32014L0042	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve"	synon përafrimin e ligjit tonë me atë të BE, të Zyrës së Rikuperimit të Aseteve në Shqipëri me Zyrën e Rikuperimit të Aseteve në BE.	Ligj	I rëndësisë së dytë (e pëlqyeshme)	MB	2024	Q3	Buxheti shtetit	1,509						
24	MB	Luftra kundër krimit të organizuar		Vendimi i Këshillit 2007/845/JHA e 6 dhjetorit 2007 në lidhje me bashkëpunimin midis Zyrave të Rimarkimitqës së Aseteve të Shteteve Anëtarë në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave nga, ose prona të lëna në dëshura me Kontro	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/TXT/?uri=celex%3A32007D0845	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve"	synon përafrimin e ligjit tonë me atë të BE, të Zyrës së Rikuperimit të Aseteve në Shqipëri me Zyrën e Rikuperimit të Aseteve në BE.	Ligj	I rëndësisë së dytë (e pëlqyeshme)	MB	2024	Q3	Buxheti shtetit	1,509						
24	MB	Kufijtë e jashtëm Shengen		Rregullorja (BE) 2016/399 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 mars 2016, mbi Kodin e Bashkimit mbi regullat që rregullojnë lëvizjen e personave jashtë kufijve.	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/SQ/TXT/?uri=celex%3A32016R0399	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar"	Ndryshimi i ligjit nr. 22/2020 "Për disa shtesa në ligjin Nr. 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar" dhe miratimi i ligjit për APIS/PNR në fatë parë gjatë procedurës ëë miratimit, ligji i Nr. 22/2020 hoqi si çjesë jashtështetësi nga Ligji 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar"dhe krijohet si ligj më vetë, sipas kërkesave të Direktivave të BE-së për të dhënat API dhe të dhënat PNR. Ligji i synon përqafimin e plotë të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Ligji i çë Mbrojtjes e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë është në process dhe është parë e anyashëme që të shtyhet afati për ndryshimin e Ligjit 22/2020 dhe miratimin e Ligjit të ri për APIS/PNR në vitin 2024 për shkak të procedurave që kërkon hartimi dhe miratimi i një ligji të ri.	Ligj	I rëndësisë së dytë (e pëlqyeshme)	MB	2024	Q3	Buxheti shtetit	1,820						
24	MB	Kufijtë e		Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2021/581 e datës 9 prill 2021 mbi njoftimet e situatës	https://eur-lex.europa.eu/eli/reg_impl/2021/581/oj	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 71/2016 "Për	Ndryshimi i ligjit nr. 22/2020 "Për disa	Ligj	I	MB	2024	Q3	Buxheti	1,820						

		jashtem Shengen		si Sistemi Evropian të Mbikëqyrjes Kufitare (EUROSUR)			Kontrollin Kufitar", i ndryshuar	shtesa në ligjin Nr. 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar" dhe miratimi i ligjit për APIP/PNR në fakt janë pjesë përbërëse të të njëjtit akt, pasi Ligji 22/2020 hqeu si pjesë përbërëse nga Ligji 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar"dhe krijohet si ligj më vetë, sipas kërkesave të Direktivave të BE-së për të dhënat API dhe të dhënat PNR. Ligji i ri synon përpunjen e plotë të legjislacionit për mbrojjen e të dhënave personale. Ligji i ri për Mbrojjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë është në proces dhe është parë e anyesh me qëllë shtyhet afati për ndryshimin e Ligjit 22/2020 dhe aprovimin e Ligjit të ri për APIP/PNR në vitin 2024 për shkak të procedurave që kërkon hartimi dhe miratimi i një ligji të ri.	rëndësisht ënsë lartë (e përpunëshme)					shtesë								
24	MB	Kufijtë e jashtëm Shengen		Rregulloja (KE) 1931/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 dhjetor 2006, që përcakton rregullat për trafikun kufitar lokal në kufijtë soliloucë të jashtëm të Shteteve Anëtare dhe që ndryshon dispositat e Konventës së Shengenit.	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=celex%3A32006R1931	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar", i ndryshuar	Ndryshimi i ligjit nr. 22/2020 "Për disa shtesa në ligjin Nr. 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar" dhe miratimi i ligjit për APIP/PNR në fakt janë pjesë përbërëse të të njëjtit akt, pasi Ligji 22/2020 hqeu si pjesë përbërëse nga Ligji 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar"dhe krijohet si ligj më vetë, sipas kërkesave të Direktivave të BE-së për të dhënat API dhe të dhënat PNR. Ligji i ri synon përpunjen e plotë të legjislacionit për mbrojjen e të dhënave personale. Ligji i ri për Mbrojjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë është në proces dhe është parë e anyesh me qëllë shtyhet afati për ndryshimin e Ligjit 22/2020 dhe aprovimin e Ligjit të ri për APIP/PNR në vitin 2024 për shkak të procedurave që kërkon hartimi dhe miratimi i një ligji të ri.	Ligj	i rëndësisht ënsë lartë (e përpunëshme)	MB	2024	Q3	Buxheti shtetë	1,820							
24	MB	Kufijtë e jashtëm Shengen		Strategjia EuropeianeTëkrënëve dhe Operacionale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit	https://www.frontex.europa.eu/assets/Key_Documents/MB_Decision/2018/MB_Decision_2_2018_adopting_a_Technical_and_Operational_Strategy_for_European_Integrated_Border_Management.pdf	Politike dhe Ligjore	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK) 2021-2027"	në zbatim të Strategjisë Ndërkombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027 dhe Planit të Veprimit 2021-2023, hartohet plani i ri i veprimit 2024-2027	VKM	N/A	MB	2024	Q1	Buxheti shtetë	1,800							
24	MB	Kufijtë e jashtëm Shengen		Direktiva BE 2016/681 të Parlamentit dhe Këshillit Europian datë 27.04.2016 mbi perdorimin e të dhenave të regjistrit të emrit të pasagjerit (PNR) me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave me qëllime terroriste dhe krime të rënda.	https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2016/681/oj	Politike dhe Ligjore	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK) 2021-2027"	Ndryshimi i ligjit nr. 22/2020 "Për disa shtesa në ligjin Nr. 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar" dhe miratimi i ligjit për APIP/PNR në fakt janë pjesë përbërëse të të njëjtit akt, pasi Ligji 22/2020 hqeu si pjesë përbërëse nga Ligji 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar"dhe krijohet si ligj më vetë, sipas kërkesave të Direktivave të BE-së për të dhënat API dhe të dhënat PNR. Ligji i ri synon përpunjen e plotë të legjislacionit për mbrojjen e të dhënave personale. Ligji i ri për Mbrojjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë është në proces dhe është parë e anyesh me qëllë shtyhet afati për ndryshimin e Ligjit 22/2020 dhe aprovimin e Ligjit të ri për APIP/PNR në vitin 2024 për shkak të procedurave që kërkon hartimi dhe miratimi i një ligji të ri.	Ligj	E plotë (e përpunëshme)	MB	2024	Q3	Buxheti shtetë	819,900							
24	MB	Kufijtë e jashtëm Shengen		Direktiva e Këshillit 2004/82/KE, datë 29 prill 2004, "Për detyrimin e transportuesve për të komunikuar të dhënat për pasagjerët"	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32004L0082	Politike dhe Ligjore	Projektligj "Për përpunimin e informacionit të pasagjerit në Republikën e Shqipërisë"	Ndryshimi i ligjit nr. 22/2020 "Për disa shtesa në ligjin Nr. 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar" dhe miratimi i ligjit për APIP/PNR në fakt janë pjesë përbërëse të të njëjtit akt, pasi Ligji 22/2020 hqeu si pjesë përbërëse nga Ligji 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar"dhe krijohet si ligj më vetë, sipas kërkesave të Direktivave të BE-së për të dhënat API dhe të dhënat PNR. Ligji i ri synon përpunjen e plotë të legjislacionit për mbrojjen e të dhënave personale. Ligji i ri për Mbrojjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë është në proces dhe është parë e anyesh me qëllë shtyhet afati për ndryshimin e Ligjit 22/2020 dhe miratimin e Ligjit të ri për APIP/PNR në vitin 2024 për shkak të procedurave që kërkon hartimi dhe miratimi i një ligji të ri.	Ligj	E plotë (e përpunëshme)	MB	2024	Q3	Buxheti shtetë	819,900							
24	MB	Migracioni i mëgël		Komunikata e Komisionit për Parlamentin dhe Këshillin Evropian mbi Strategjinë e BE-së për kthimin dhe rintegrimin vullnetar, datë 27.04.2021 - EUR-Lex - 52021DC0120.Perafrimi i metejshëm me politikën e Palës së BE-së per migracionin dhe azilin; Permirësimi i politikave per kthimin dhe rintegrimin ne perpjekjtë me BE; Forcimi i bashkëpunimit me vendet e origjinës me qëllim rënësimin e gjendë e një politike të drejtë, efektive dhe gjithëpërfshirëse të BE-së për migracionin; Përforcimi i kapaciteteve mbi kthimin, njohjen dhe rintegrimin e shtetasve me mbretërinë e vendëve te BE.	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX%3A52021DC0120	Politike dhe Ligjore	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Planit të Veprimit 2024-2026"	Komunikata e Komisionit për Parlamentin dhe Këshillin Evropian mbi Strategjinë e BE-së për kthimin dhe rintegrimin vullnetar, datë 27.04.2021	VKM	N/A	MB	2024	Q1	Buxheti i shtetë dhe donatorët	207,936	344,655	170,974					
Kulturë Ekonomik	MFE	1.Ekzistenca e një ekonomie fragë funksionale	Tregu i punës	Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore (Rek. Shqipëria duhet të zhvillojë një Plan Zbatimi të Garancisë për të Rinjtë dhë instrumentat institucionalë për të monitoruar nevojat e aftësive të kërkuara në tregun e punës)	N/A	Institucionale dhe Administrative	Zbatimi i fazës Pilot të Planit të Miratur të Garancisë Rinore	- Lancimi i Fazës pilot - Rëgjistrja mekanizmash dhe e informacionit nga fazës pilot - Monitorimi i punës së atyre	N/A	N/A	MFE	2024	Q3	Buxheti shtetë	200,000							
5	APP	N/A	Sektori Klasik	Direktiva 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, "Mbi prokurimin publik dhë që shfuqizon direktivën 2004/18/KE"	http://data.europa.eu/eli/dir/2014/24/oj	Politike dhe Ligjore	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar"	Përafrimi i mëtejshëm me Direktivat e BE. Zvullimi dhe zgjerimi në VKM i koncepitë të veprimtarisë ndërmjetësuese, saktësimi i munësitë të dokumentit të kthimit të mostrave në procesin e prokurimit, etj.	VKM	E plotë (e përpunëshme)	APP	2024	Q2	Buxheti shtetë	1,202							
5	APP	N/A	Sektori Utilitar	Direktiva 2014/25/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, "Për prokurimin nga enditetë që operojnë në sektorët e ujë, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhë që shfuqizon direktivën 2004/17/KE"	http://data.europa.eu/eli/dir/2014/25/oj	Politike dhe Ligjore	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar"	Përafrimi i mëtejshëm me Direktivat e BE. Zvullimi dhe zgjerimi në VKM i koncepitë të veprimtarisë ndërmjetësuese, saktësimi i munësitë të dokumentit të kthimit të mostrave në procesin e prokurimit, etj.	VKM	E mirë (e plotë)	APP	2024	Q2	Buxheti shtetë	1,202							
